41.	Projektvendim “Për miratimin në parim të kuadrit të bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm 2022 – 2026, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara	Projektvendim	Kryeministria
42.	Projektvendim “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021-2025”	Projektvendim	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
43.	Projektvendim “Për krijimin e Këshillit Koordinues të Alb-Shkencës në Diasporë”	Projektvendim	Min. Shtetit për Diasporën
44.	Projektligji, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”	Projektligj	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
45.	Projektvendim “Për miratimin e Planit Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+, 2021 - 2027"	Projektvendim	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
46.	Projektvendim “Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve afganë dhe personave pa shtetësi me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit dhe për krijimin e Task Forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuarve të mbrojtjes ndërkombëtare”,	Projektvendim	Ministria e Brendshme
47.	Projektvendim “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 - 2026”	Projektvendim	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
48.	Projektvendim “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023"	Projektvendim	Ministria e Brendshme
49.	Projektligji “Për statusin “Fëmijë në nevojë të Republikës””,	Projektligj	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale + Ministria e Financave dhe Ekonomisë
50.	Projektligji “Për bashkëqeverisjen”	Projektligj	Kryeministria
51.	Projektvendim “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Bashkërendimit të Ndihmës”,	Projektvendim	Kryeministria
52.	Projektvendim “Për sistemin e njohjes së të nxëniet të mëparshëm joformal dhe informal”	Projektvendim	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
53.	Projektvendim “Për miratimin e rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”	Projektvendim	Ministria e Brendshme
54.	Projektvendim "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësive Intelektuale"	Projektvendim	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
55.	Projektvendim “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021-2025” bashkërendim	Projektvendim	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
56.	Projektvendim “Për miratimin e Planit Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+, 2021 - 2027" bashkërendim	Projektvendim	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
57.	Projektvendim “Për sistemin e njohjes së të nxëniet të mëparshëm joformal dhe informal”	Projektvendim	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
58.	Projektvendim “Për funksionimin, organizimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Muzeut Kombëtar të Pavarësisë, Vlorë”	Projektvendim	Ministria e Kulturës

Për vitin akademik 2021-2022 IAL-të në total kanë aplikuar për:

- 246 aplikime programe për hapje dhe riorganizim (Programe profesionale, Bachelor, Master profesional, Master i shkencave, Master ekzekutiv dhe doktoratë).
- 11 aplikime për hapje/riorganizim për njësi kryesore dhe hapje IAL.
- 10 aplikime për mbyllje programesh studimi

- Bachelor 77 aplikime, 41 kanë qene në proces vlerësimi dokumentacioni plotësues nga MASR dhe ekspertët e fushave (25 hapje, 16 riorganizime), 36 janë rrëzuar në fazën e parë (36 hapje).
- Miratuar 14 riorganizime dhe 19 hapje programesh.
- Master i Shkencave 51 aplikime, 25 janë në proces vlerësimi dokumentacioni plotësues nga MASR dhe ekspertët e fushave (19 hapje, 6 riorganizime), 26 janë rrëzuar në fazën e parë (25 hapje, 1 riorganizim).
- Miratuar 15 hapje, 4 riorganizime dhe 1 hequr dorë.
- Master Profesional - 45 aplikime, 23 janë në proces vlerësimi dokumentacioni plotësues nga MASR dhe ekspertët e fushave (13 hapje, 10 riorganizime), 22 janë rrëzuar në fazën e parë (23 hapje);
- Miratuar 15 hapje, 10 riorganizime dhe 1 master profesional rrëzuar.
- Programe profesionale - 39 aplikime, 18 janë në proces vlerësimi dokumentacioni plotësues nga MASR dhe ekspertët e fushave (8 hapje, 1 riorganizim), 21 aplikime janë rrëzuar (20 hapje, 1 riorganizim).
- Miratuar 13 hapje dhe 1 riorganizim
- Master ekzekutiv - 9 aplikime, 1 është në proces vlerësimi dokumentacioni plotësues nga MASR dhe ekspertët e fushës dhe janë rrëzuar 8 aplikime në fazën e parë.
- Miratuar 1 hapje programi.
- Doktoratë – 62 aplikime, janë në shqyrtim nga MASR
- Mbyllje programesh - 10 aplikime, të cilat janë në proces për përgatitjen e urdhrave përkatës pas marrjes së informacionit nga QSHA.
- Miratuar mbyllje 10 programe. Njësi kryesore & IAL - 11 aplikime: 5 hapje IAL – janë refuzuar 2 aplikime dhe 3 aplikime janë në proces vlerësimi dokumentacioni plotësues dhe verifikim standarde nga MASR dhe ne rast plotësimi te standardeve më kalojnë për vlerësim te eksperteve institucional.
- Jane 3 rrezuar aplikime dhe 2 ne proces.
- Hapje/riorganizim njësi kryesore, 2 riorganizime njësi kryesore (fakultet) janë miratuar me, 2 hapje njësi kryesore miratuar, si dhe 1 aplikim për hapje njësi kryesore rrëzuar.

Drejtoria e Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, gjatë 12-mujorit 2021, ka realizuar.

1. Është hartuar Kontributi i I i Qeverisë Shqiptare për Progres Raportin/ Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura", Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor" për periudhën 1 Qershor 2020 – 31 Mars 2021 (dërguar në MEPJ në muajin Prill).
2. Është hartuar Kontributi i II i Qeverisë Shqiptare për Progres Raportin/ Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura", Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor" për periudhën Prill – Qershor 2021 (dërguar ne MEPJ në Qershor 2021)
3. Është hartuar kontributi narrativ, matrica e akteve ligjore të cilat do të përafrohen me acqui-të e BE, si dhe përkthyer në gjuhën angleze, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023 për Kapitullin 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor" dhe për Kapitullin 26 "Arsimi dhe Kultura" (Janar 2021).
4. Është hartuar dhe dërguar në MEPJ kontributi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për takimin e 12-të të Nënkomitetit Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit, përkatësisht për pikën 2.3 Regulated Professions. Mutual recognition of professional qualifications: update on legislative alignment ëith the EU acquis; implementation of existing legislation, including the Laë on Regulated Professions dhe Institutional and administrative capacity. (Maj 2021).
5. Është mbledhur nga drejtoritë përmbajtjes dhe agjencitë e varësisë të MASR dhe përpunuar kontributi narrativ për Nënkomitetin e 12-të Inovacioni, Shoqëria Informacionit dhe Politikat Sociale. Takimi u zhvillua online via Eebex, në 28 janar 2021.
6. Në kuadër të organizimit të Ministerialit mbi Platformën e Ballkanit Perëndimor për Arsimin dhe Trajnimin, dhe Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin, në 27 Maj 2021, janë analizuar materialet e dërguara nga shërbimet e Komisionit Evropian, përkthyer në gjuhën shqipe, dërgua për mendim tek drejtoritë e përmbajtjes në MASR dhe institucionet e përfshira si MFE, MEPJ; mbledhja dhe përpunimi i opinionëve dhe rekomandimeve të ardhura i dokumenteve kyçe si Deklarata e Përbashkët, Vendimi i Komisionit dhe Agjenda e Ballkanit Perëndimor.
7. Është përditësuar lista e anëtarëve të GNPIE për të dy Kapitujt 25 dhe 26 si dhe është përditësuar lista e institucioneve kontribuuese në këto kapituj, gjithashtu është zyrtarizuar me shkresë pozicioni i nënkryetarit për kapitullin 25 dhe 26.
8. Po punohet me anëtarët e GNPIE-së për përditësimin e draft-tabelës së Mangësive Ligjore (IAGA) dhe draft-tabelës së Mangësive Institucionale dhe Administrative (IAGA), për Kapitullin 25 dhe 26.
9. Është duke u punuar me metodologjinë e re për hartimin e PKIE 2022-2024.
10. Është nënshkruar “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë në fushën e Arsimit”, më 6 janar 2021.
11. Është nënshkruar “Memorandumi i Mirëkuptimit midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Hungarisë për bashkëpunim në kuadër të programit hungarez të bursave për vitet 2021-2024”, më 12 shkurt 2021, Tiranë.
12. Janë kryer procedurat për 2 (dy) bursat kineze për vitin akademik 2021-2022.
13. Janë kryer procedurat për 20 (njëzet) bursat hungareze për vitin akademik 2021-2022.
14. Janë kryer procedurat për 3 (tre) bursat verore të gjuhës bullgare për korrik-gusht 2021.
15. Janë kryer procedurat për 2 (dy) bursat sllovaqe për vitin akademik 2021-2022.

16. Janë kryer procedurat për zhvillimin e vizitës së Ministrit Turk të Arsimit Kombëtar në Shqipëri dhe takimin me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
17. Janë kryer procedurat për ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit shqiptar të BFUG.
18. Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit me Ambasadën Italiane për programin Iliria.
19. Kemi shpallur aplikimet për pjesëmarrjen në Konkursin e Artit “Lidice”, në bashkëpunim me ambasadën e Republikës Çeke, 2021.
20. Është nënshkruar “Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Italisë në Republikën e Shqipërisë”, në Tiranë, më 15.5.2021;
21. Po diskutohet “Programi ekzekutiv i bashkëpunimit kulturor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për vitet 2021-2025”.
22. Po kryhen negociatat për marrëveshjen Horizon Europe me Komisionin Evropian.
23. Është shqyrtuar dhe miratuar “Deklarata e Përbashkët për një Agjendë të Ballkanit Perëndimor mbi Inovacionin, Kërkimin, Edukimin, Kulturën, Rininë dhe Sportin” ndërmjet KE dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.
24. Është hartuar projektprogrami i bashkëpunimit me Maqedoninë e Veriut për vitet 2021-2025.
25. Janë kryer negociatat me RCC dhe vendet e Ballkanit Perëndimor për dy projekt marrëveshjet rajonale për njohjen e kualifikimeve akademike dhe njohjen e kualifikimeve profesionale.
26. Përfaqësuesit e DIKMA-s kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga KE me vendet e BP në Eastern Balkan Platform on Education & Training, and Research & Innovation.
27. Është përditësuar dhe plotësuar, dhe dërguar në MEPJ informacioni për bashkëpunimin me:
Turqinë dhe Rumaninë, Hungarinë, Italinë, Spanjën dhe Maltën, Protokolli me Austrinë, Programi me Bullgarinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Danimarkën, Holandën, Finlandën, Suedinë, Norvegjinë dhe Islandën, etj.
28. Ka përfunduar negociimi i marrëveshjes ndërkombëtare midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Unionit Horizon Europe - Programi Kuadër për Kërkimin dhe Inovacionin.
29. Ka përfunduar procedura e përzgjedhjes së 11 studentëve të cilët kanë aplikuar në thirrjen e publikuar në faqen zyrtare të MAS për përfitimin bursave të studimit në Universitetin Teknik të Stambollit (UTS) Turqi, viti akademik 2021-2022.
30. Janë përcaktuar përfaqësuesit e qendrave Europass dhe Euroguidance për Qendrat Kombëtare Euroguidance, Europass dhe NCP për EQF (4 përfaqësues nga MAS dhe 1 përfaqësues nga MFE).
31. Janë përcaktuar përfaqësuesit e grupeve të punës në kuadër të ciklit të parë (2021 – 2025) të Kuadrit strategjik për bashkëpunimin evropian në fushën e arsimit dhe formimit drejt Zonës Evropiane të Arsimit e më tej (2021 – 2030) (përfaqësues nga MAS dhe ASCAP).
32. Është dërguar palës izraelite nëpërmjet MEPJ dhe emailit në Ambasadë, propozimi i MASR për “Projektprogramin e bashkëpunimit në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, rinisë dhe sportit nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për periudhën 2021-2024”.
33. Është nënshkruar “Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë mbi Programin “Iliria” për Mësimin e Gjuhës Italiane në Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” nënshkruar në Tiranë më 18 maj 2021;
34. Është ngritur grupi i punës për lehtësimin e zbatimit të marrëveshjes, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin në fushën e arsimit”, i kryesur nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe janë përfunduar procedurat dhe shkresa për leje për takimin e zhvilluar në Ankara më 7 korrik 2021;
35. Është negociuar dhe firmosur nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë “Memorandumi i Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e përbashkët në arsimin e lartë midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës”, janë përfunduar të gjitha procedurat përkatëse mbi këtë memorandum;
36. Është përditësuar dhe dërguar në MEPJ informacioni mbi bashkëpunimin me Kosovën dhe marrëveshjet përkatëse në fushën e arsimit dhe sportit, në kuadër të takimit të Kryeministrit z. Edi Rama;
37. Janë përgatitur procedurat përkatëse mbi takimet e Ministres, përgatitje e dosjes me informacionin e nevojshëm dhe kërkesa për leje drejtuar MEPJ dhe KM, përkatësisht takimet e zhvilluara në: Londër, Tokio, Lubjanë, Itali, Kosovë, Budapest, Spanjë, Maqedoni e Veriut, Bern, Ukrainë, Hungari, Greqi dhe Hungari;
38. Përgatitja e dosjes për ministres në kuadër të pritjes së delegacionit ukrainas;
39. Është publikuar dhe promovuar kërkesa për bursat ukrainase, çeke dhe uzbekistanase;
40. Janë ndjekur procedurat për zbatimin e marrëveshjes me Universitetin e Bolonjës;
41. Është shqyrtuar Marrëveshja për pjesëmarrje në TIMSS 2023 dhe është dhënë dakordësimi nga ana e DIKMA;
42. Është përgatitur informacioni, action plan dhe agjenda në kuadër të konferencës China-CEEC dhe Këshillit Ndërkombëtar të Sporteve dhe Lojrave Tradicionale të ndjekura online nga Zv. Ministri Z. Oltjon RRumbullaku;
43. Janë marrë masat dhe është përcjellë shkresa drejtuar MEPJ mbi lehtësimin e procedurave për vizë të përshpejtuar dhe punësimin në vendet pritëse të studentëve afganë;
44. Është përgatitur informacioni për ministren në kuadër të takimit SEEIST;

45. Janë kryer procedurat dhe përgatitjet e nevojshme mbi takimin e sesionit të 8-të të Komisionit të Përbashkët mbi bashkëpunimin Shqipëri-Austri;
46. Është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për shlyerjen e pagesës ERISSE;
47. Janë ndjekur procedurat për miratimin e programit me Bullgarinë për vitet 2021-2023;
48. Është hartuar urdhri për mbështetje financiare si dhe shkresa drejtuar Universitetit të Mynyhut mbi rishikimin e marrëveshjes në kuadër të Programit Universitar Albanologjik me Universitetin Ludëig-Maximilian në Mynyh (LMU).

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për vitin 2021 ka realizuar detyra si më poshtë;

1. Miratimi, shpërndarja, ndjekja e zbatimit të **fondeve të buxhetit për vitin 2021**, të miratuara me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”,
 - a. Miratimi, shpërndarja e fondeve të buxhetit për të gjitha institucionet e sistemit të MASR, për vitin 2021-2023;
 - b. Miratimi, shpërndarja e shpenzimeve mujore të fondeve për të gjitha institucionet e sistemit të MASR, për vitin 2021;
2. Hartimi i planit të **shpenzimeve në valutë** për institucionet arsimore për vitin 2021;
3. Hartimi dhe **shpërndarja e fondeve të buxhetit** për institucionet e sistemit të MASR, për periudhën afatmesme 2021-2023;
4. Hartimi dhe **shpërndarja e fondeve për investimet** për institucionet e sistemit të MASR, për periudhën afatmesme 2021-2023.
5. **Përgatitja e Deklaratës Vjetore** “Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për vitin 2020”. **Plotësimi i Pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2020**. (pyetjeve të pyetësorit sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (Neni 19, i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar). Shkresa dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 1283, datë 26.02.2021;
6. Plotësimi i regjistrit të Riskut për DBMF 2020-2021.
7. **Përgatitja e raportit të monitorimi të konsoliduar, të zbatimit të buxhetit për vitin 2020**, së bashku me anekset e monitorimit (aneksi 13-të) për vitin 2020 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 12 mujor Janar – Dhjetor 2020; **Shkresa** dërguar për **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 1283/2, datë 01.03.2021**;
8. **Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2020**; **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 2274, datë 20.04.2021;
9. **Mbështetja me ekspertize për financat dhe buxhetin** për përgatitjen e kapitujve 25 dhe 26 të Acquis Communautaire. Janë hartuar dhe dërguar përgjigje kontribute në kuadër të nën-komiteteve dhe komiteteve të ndryshme siç janë ai i Çështjeve Ekonomike e Financiare, Komiteti Stabilizim Asociimit, Inovacioni, Shoqëria Informacionit dhe Politikat Sociale, si dhe plotësimi i rekomandimeve afatshkurtra të raportit të Komisionit Evropian;
10. **Hartimi i PBA 2022-2024. (Faza e parë)** Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2022-2024, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2016-2021), sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 8, datë 26.2.2021 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, si dhe tavanet e miratuara me **Vendimit nr. 119, datë 3.03.2021** të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”. **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 1121/1, datë 04.05.2021;
11. Kërkesat “**Fonde për Shtese 2022-2024**”, nga MASR është dërguar shkresa e ne MFE nr. 2948, datë 24.05.2021;
12. **Hartimi i PBA 2022-2024. (Faza e dyte)**; Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2022-2024, **Shkresë Nr. 3926, dt 13.7.2021 Dërguar Institucioneve “Per pergatitjen PBA 2022-2024”**. Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2016-2021, sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr.8, datë 26.2.2021 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, **si dhe tavanet e miratuara me Vendimit nr.440, datë 22.7.2021** të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”. **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 4188/2, datë 01.09.2021;
13. **Hartimi i PBA 2022-2024**. Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2022-2024, **(Faza e dyte)** Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2016-2021), sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 8, datë 26.2.2021 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, si dhe tavanet e miratuara me **Vendimit nr. 440, datë 22.7.2021** të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”. **Shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr.4188/2, datë 01.09.2021;

14. **Kërkesa për fonde për shtese 2022-2024**, nga MASR ne MFE është dërguar shkresa nr.4188/3, date 01.09.2021;
15. Raportime në Ministrinë e Financave për **detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi për vitin 2020**, si dhe borxhet e mbartuara nga viti 2019, **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. **448/1, date 23.01.2021**;
16. **Raportime në Ministrinë e Financave për detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi nga zbatimi i vendimet gjyqësore** të formës së prerë të likuidura me fonde buxhetore për periudhën 3-mujorin 2021, **shkresa** dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 2166/1, datë 14.04.2021, raportimi 3-mujor MFE shkresa nr. 3747/64, datë 15.07.2021; raportimi 6-mujor MFE shkresa nr. 37347/64 , datë 15.07.2021;
17. Raportime në Ministrinë e Financave **për shpenzimet në valutë për institucionet arsimore**, për 3-mujorin, 6- mujori, 9-mujori, dhe progresiv vjetor 2021;
18. **Analizë dhe përgatitje e shkresave/autorizimeve** për nëpunësin autorizues si dhe nëpunës zbatues të institucioneve arsimore;
19. **Analizë dhe përgatitje e autorizimeve për udhëtime e dieta të punonjësve** të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
20. **Analizë dhe përgatitje e autorizimeve për pagesën nga fondi i vecantë të punonjësve** të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
21. **Pjesëmarrja në grupe pune**, për hartimi i projekt akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar dhe universitar në tërësi dhe për pjesën financiare në veçanti, konform Matricës së akteve ligjore dhe nënligjore të parashikuara për vitin 2021.
22. **Planifikimi dhe ndjekja e procedurave për implementimin e projekteve me financim të huaj**, mbështetur ne Planin Vjetor të Reformes si dhe ndjekja dhe monitorimi i projekteve dhe pagesave të projekteve të tjera të huaja (kosto lokale dhe TVSH). Raportimi në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë **për çdo muaj** sipas kërkesave specifike.
23. **Në kuadër të planit të integritetit evropian**, është hartuar Kontributi i II i Qeverisë Shqiptare për Progres Raportin/ Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura", **Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor"** për pjesën e fondeve në arsim sipas kapitujve;
24. Është hartuar Kontributi i III i Qeverisë Shqiptare për Progres Raportin/ **Kapitulli 26 "Arsimi dhe Kultura"**, Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor", **për pjesën e fondeve në arsim sipas kapitujve**;
25. Janë hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Intergrimit, për MEPJ, si dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kontribute në kuadër të nën-komiteve dhe komiteve të ndryshme siç **janë ai i Çështjeve Ekonomike e Financiare**, Komiteti Stabilizim Asociimit, Inovacioni, Shoqëria Informacionit dhe Politikat Sociale, si dhe plotësimi i rekomandimeve afatshkurtra të raportit të Komisionit Evropian.
26. **Monitorime analiza për produktet kryesore**, si numri i punonjësve, pagave të punonjësve si dhe shpenzime personeli në Arsim, transportin e nxënësve dhe mësuesve, bursat dhe kuotat ushqimore, tekstet shkollore dhe kompesimi i tyre, investimet kapitale, si dhe trajtimi i problematikave në arsimin e lartë në IAL publike, etj.
27. **Pjesëmarrje në grupe pune në MASR**, për hartimin projektvendimeve, projektudhëzimeve dhe projektudhëra, apo akte të tjera nënligjore në kuadër të reformës në arsim.
28. **Realizimi i rishpërndarjeve të fondeve të buxhetit për vitin 2021**, miratuar me ligjin nr. 137/2021 “Për buxhetin e vitit 2021”.
29. Pjesëmarrje në grupe pune në MASR për hartimin e specifikimeve teknike si dhe fondit limit për procedura prokurimi të parashikuara për vitin 2021.
30. **Hartimi i projektvendimeve të hartura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar**, si dhe hedhja në sistem e projektvendimeve, për të cilat jemi ngarkuar.
31. **Ndjekja dhe monitorimi i detyrimeve të prapambetura**, në zbatim të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, **janë realizuar analiza dhe dërguar raporte dhe informacione për Titullarët dhe në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për vitin 2020, për 3-mujor 2021, si dhe 6 mujorin , 9-mujorin si dhe progresiv vjetor 2021**, i detajuar me të dhëna lidhur me;
 - a) *Historikun e detyrimeve të prapambetura, problematikave e situatës, shkaqet dhe arsyet e pamundësisë së deritanishme për të shlyer këto detyrime, masat konkrete të marra deri tani në këtë drejtim;*
 - b) *Detyrimet e krijuara rishtazi dhe të akumuluar deri në 31 dhjetor 2021;*
 - c) *Vlera e likuiduar e detyrimeve të prapambetura deri më 31 dhjetor 2021;*
 - d) *Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, si edhe për një periudhë afat-mesme 2022-2024.*
32. **Monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve**, përdoren një sërë procedurash **nga titullarët**, nëpunësit Autorizues dhe zbatues si dhe drejtuesit e tjerë të lartë. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për e monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA.

1. Në bashkëpunim me DAP janë realizuar procedurat për shpalljen e publikimeve për plotësimin e nevojave të institucionit **për 8 vende vakante për vitin 2021 dhe 10 procedura pezullimi, 4 procedura të lirimit nga shërbimi civil për shkak të moshës së pensionit dhe 9 procedura për praktikante në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës.** për nëpunësit civilë të MASR; ndjekja e të gjithë procesit të shpalljes së vendeve vakante në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, institucionet qendrore dhe ato të varësisë; marrja e masave dhe kryerja e praktikave për caktimin e punonjësve të MASR në Komisionet e përzgjedhjes së kandidatëve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
2. Ndjekja e procesit të konfirmimit të **17 punonjësve të MASR**, si nëpunës civilë, pas përfundimit të periudhës 1-vjeçare të provës në shërbimin civil;
3. Ndjekja e grafikut të trajnimeve pranë ASPA-s, **për 54 punonjës të MASR-së.** Gjatë vitit 2021, për shkak të pandemisë Covid-19, trajnimet janë realizuar online ku nëpunësit janë regjistruar në mënyrë individuale. ASPA ka ofruar **ëbëinare** me tematika të ndryshme për të gjithë nëpunësit e MASR;
4. Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur asnjë procedurë për shkelje disiplinore për nëpunësit e MASR.
5. Organizimi dhe bashkëpunimi për trajnimin e **146 oficerëve të sigurisë, si dhe 40 punonjësve socialë/psikologëve** organizuar nga programi Suedez për policimin në komunitet në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme;
6. Ndjekja e procedurave për deklarimin para fillimit/pas largimit nga funksioni dhe periodik për **11 punonjës të MAS** dhe institucioneve të varësisë;

Spektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore

1. Spektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, për periudhën **Janar-Gusht 2021**, ka përgatitur/hartuar dokumentacionin ligjor të përfaqësimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si autorizime, kërkesëpadi, prapësime, ankime, kundër ankime, **për 59 çështje gjyqësore (administrative/civile/penale) në të cilët ka qenë palë ndërgjyqëse, si dhe 22 ankime, 15 kundër ankime, 1 kundër rekurs për çështjet e ndjekura.** Në kuadër të përgatitjes së prapësimeve, sektori ka bashkëpunuar dhe me njësi të tjera në MAS.
2. Spektori ka administruar dosjen e çdo çështjeje gjyqësore, si dhe ka plotësuar në vijimësi të ecurisë gjyqësore të çështjeve të administruara pranë tij. Spektori ka përgatitur të gjithë dokumentacionin që i përket secilës çështje, si vendimin gjyqësor përkatës, ankimin/kundër ankimin, rekursin/ kundër rekursin, si dhe dokumente/akte të tjera të depozituara në cilësinë e provës.
3. Spektori ka përfaqësuar dhe vijon përfaqësimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në seancat gjyqësore për të gjitha çështjet ku është palë ndërgjyqëse, deri në përfundimin e procesit gjyqësor me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Objektiv 4). Auditimi i 30% dhe inspektimi në 10-12% të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, mbështetur në planin vjetor, të miratuar nga Ministri me prot/ nr. 5845, datë 30.10.2020, ka përcaktuar objektivat me programe konkrete, për realizimin e misionit të auditimit si:

- Dhënies përparësi për auditim, atyre fushave që janë vlerësuar me rrishtë të mesëm dhe të lartë;
- Përmirësimin e kapaciteteve të auditit;
- Përmirësimin e programeve dhe metodologjisë së auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në institucionet e audituara, ka kryer vlerësimin sistemit të kontrollit të brendshme dhe nga këto vlerësime vërehet se, këto sisteme janë ngritur dhe janë vlerësuar me nivel mesatar.

Analiza e programeve të AB, për periudhën raportuese:

- Hartimi i planit vjetor, është bazuar në kapacitetet e planifikuara të burimeve që ka kjo drejtori si dhe në vlerësimin e rrishtë të institucioneve të varësisë.
- Për periudhën (Janar - Dhjetor) 2021, ishin planifikuar për të u realizuar 15 auditime në 15 institucione dhe janë realizuar 14 auditime në 14 institucione;

Rekomandimet e propozuara gjithsej 83, nga këto:

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, gjithsej 8
- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, gjithsej 3
- Rekomandime të karakterit organizativ, gjithsej 61
- Rekomandime për arkëtime, gjithsej 1

Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, është vlerësuar si një proces i pandërprerë dhe i vazhdueshëm gjatë gjithë veprimtarisë, ku marrin pjesë të gjithë punonjësit e subjektit të audituar, ky vlerësim është bërë sipas këtyre komponentëve:

- Për ambientin e kontrollit të brendshëm;
- Për vlerësimin e rrishtë;

- Për kontrollin e aktivitetit operacional;
- Për sistemin e informimit dhe të komunikimit;
- Për monitorimin;
- Sistemet e kontrollit të brendshëm për administrimin e aktiveve.

Prioritetet në vazhdim:

- Përmirësimi i procesit të vlerësimit të riskut, mbi bazën e të cilit të hartohen programet e angazhimit të auditimeve;
- Zgjerimi i aftësive për të kryer auditime mbi bazë risku dhe sistemi;
- Dobishmëria dhe efektiviteti me impakt konkret, në arritjen e objektivave të institucioneve, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për njësitë e audituara.

Fondet e programit “Planifikim Menaxhim” 01110,

Fondet e programit “Planifikim Menaxhim” 01110, sipas planit 2021, janë planifikuar 722 milion lekë, nga të cilat 667 milion lekë janë fonde për shpenzime korente ose 92.4% e fondeve të këtij programi, si dhe 55 milion lekë ose 7.6% janë planifikuar për shpenzime kapitale/ investime. Fondet e programit “Planifikim Menaxhim janë në masën 1.6% e fondeve të arsimit, në masën 0.04 ndaj PBB, si dhe ndaj shpenzimeve publike në masën 0.12%.

Fondet e rishikuara të këtij programi pas rishpërndarjes të fondeve në vitin 2021, janë në masën 742.5 milion lekë ose 1.6 % e fondeve të MASR.

Realizimi për periudhën 12-mujore është në masën 727.9 milion lekë ose në masën 98% ndaj planit vjetor 2021, fondet e realizuara arrijnë në 1.6% të shpenzimeve të realizuara për arsimin. Fondet e realizuara në programin “Planifikim Menaxhim janë në masën 1.6% e fondeve të arsimit, në masën 0.04 ndaj PBB, si dhe ndaj shpenzimeve publike në masën 0.12%.

a) Fondet për shpenzime personeli për vitin 2021.

Fondet e miratuara në zërin “Pagat dhe sigurimet shoqërore, artikulli 600-601”, për vitin 2021, arrijnë nga 560.3 milion lekë, fondet e rishikuara pas rishpërndarjes me akte normative për vitin 2021, arrijnë në shumën 576.9 milion lekë ose **78.6%** e fonde të rishikuara për këtë program. Realizimi për vitin 2021 është në masën **572.2 milion lekë ose në 99%** ndaj fondit të planifikuar për vitin 2021.

Fondet për shpenzime personeli për vitin 2021 kanë mbuluar pagat si dhe sigurimet shoqërore për 672 punonjës nga të cilët;

- 1) Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për 134 punonjës (pas ndryshimeve të strukturën e miratuar/ ndryshuar për vitin 2021, ky numër është **134 punonjës**)
- 2) Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, **4 drejtori**, si dhe **52 Zyra Vendore Arsimore** me 510 punonjës e specialistë;
- 3) Agjencia Sigurimit të Cilësisë në Arsimin parauniversitar (ASCAP), ish-Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, për **28 punonjës** (pas ndryshimeve të strukturës e miratuar për 2019).

b) Fonde për krijimin e kushteve të punës (artikulli 602-605) për rreth 672 punonjës në Aparatin e MASR si dhe DRAP/ZVAP dhe ASCAP, (ish-DAR/ZA dhe ish-Inspektoriati Shtetëror i Arsimit), për vitin 2021 janë planifikuar **106.7 milion lekë** në vit ose 15.8% e fondeve të miratuara për këtë program. Fondet e **buxhetit të rishikuar për shpenzime korente janë në masën 92.1 milion**, ku sipas përparësive janë parashikuar; fonde për të mbuluar shpenzimet për likuidimin detyrimeve për, energji elektrike, telefon, internet, ujë, karburant, udhëtime e dieta, kancelari, materiale deh shërbime të tjera zyre, si dhe të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Shpenzime për trajnimin e punonjësve të MASR, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve etj.

Realizimi për vitin 2021 është në masën 88.8 milion lekë ose në masën 98%, ndaj fondit të planifikuar për vitin 2021.

c) Fondet për shpenzime kapitale për vitin 2021:

Fondet për shpenzime kapitale për vitin 2021, janë miratuar **55 milion lekë**, ose 7.6% e fondeve të këtij programi. Synim kryesor është përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve të infrastrukturës me qëllim përmirësimin e kushteve të punonjësve në institucione arsimore ku përfshihen katër DRAP Zyrat Vendore Arsimore, ASCAP, si dhe Aparati i MASR. Burimi financimit është 100% nga buxheti i shtetit, për vitin 2021. Pas rishikimit me akte normative në vitin 2021 në këtë program për shpenzime kapitale janë në masën 70 milion lekë, realizimi për vitin 2021 është në masën 63.6 milion lekë ose 91% e fondeve të miratuara për vitin 2021.

c.1 Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese janë 60.9 milion lekë, këto fondet janë detajuar sipas projekteve për institucionet vendore arsimore janë duke u ristrukturuar “*Rikonstruksion i mjediseve të ish-magazines dhe zdruktharise të ZVA Korçe-Pustec, Projekti për ndertimin e Zyres Vendore Arsimore Maliq*”, si dhe “*Rikonstruksione të ambjenteve zyrat e mjedise të rinovuara/ ndertuara ZVA Has, Rikonstruksione të ambjenteve zyrat e mjedise të DRAP*

Lezhe” në zbatim të Vendim nr. 99, datë 27.2.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”. Realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën 8-mujore është në masën 59.1 milion lekë ose 100% e planifikuar për vitin 2021.

c.2 Fondet e parashikuara për blerje pajisje orendi ”Pajisje te ndryshme - Aparati MASH” në shumën prej 4.5 milion lekë, procedurë prokurimi të përqëndruar tek Ministria e Brendshme , fondet janë realizuar në masën 4.5 milion lekë ose 46.6% e fondeve.

c.3 Fondet e parashikuara për blerje pajisje orendi ” Blerje pajisje elektronike dhe softje informatike per sherbimet ne MAS, DRAP/ZVA” në shumën prej 4.5 milion lekë, nuk janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2021, në këtë program është në MASR në masën **98%** dhe përfaqëson rreth 1.6% të totalit të shpenzimeve të realizuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë për 2021, sipas zërave kryesore.

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korentë **99%**

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale **91%**

Gjithsej 98%

Tabela nr. 1_(01110 PM) Fondet e realizuara në vitin 2020, fondet e planifikuara PBA 2021, fondet e miratuara në ligjin vjetor 2021, fondet e rishikuara për vitin 2021, si dhe dhe fondet e realizuara për 12-mujorin e vitit 2021, në 000 lekë dhe në %.

NEKSI Nr.2

ut sipas Artikujve per Buxhetin 2021 (cdo 4 mujor progresive)

12 Mujori 2021

ne 000 leke

Ministria

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISE

Kodi

11

Programi


Planifikim Menaxhim

Titulli

01110

</

Planifikim Menaxhim	
Buxheti i rishikuar per vitin 2021 ne mijë lekë	
Pagat e punonjësve	492,580 67%
Sigurime Shqetore	84,313 11%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	88,987 12%
Subvencione	0 0%
Transferata Korente të Brendshme	0 0%
Transferata Korente të Huaja	0 0%
Trans per Bush, Fam. & Individ	3,123 0%
Kapitale të Patrupëzuara	0 0%
Kapitale të Trupëzuara	70,000 9%
	739,003 100%



Faktorë që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12-mujorin vitin 2021;

- Shpenzimet e personelit janë realizuar në masën 99%,** pasi nuk është plotësuar numri i miratuar i punonjësve sipas strukturave të miratuara për vitin 2020-2021, pas rristrukturimit dhe plotësimi i numrit të punonjësve të miratuar për ZVAP, në zbatim të Vendimit nr. 99, datë 27.2.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, si dhe Vendimit nr. 98, datë 27.2.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për këtë arsye shpenzimet e personelit nuk janë realizuar ne masën 100%.
- Urdhër nr.91, datë 09.03.2020 i Ministrit përgjegjës për arsimin** “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, i ndryshuar.
- Urdhëri nr. 135, datë 09.03.2020 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** ”Për mbylljen e institucioneve Arsimore për parandalimine përhapjes së COVID 19”; i ndryshuar; <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/03/Urdher-135-Per-Mbylljen-e-Instit-Arsimore.pdf>https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/03/Urdher-132-Mbylljen-e-aktiviteve-publike-dhe-jopublike-dhe-anullimin-e-grumbullim-eve-masive_.pdf
- Pezullimit apo shtyrja e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik,** nga Agjencia e Prokurimit Publik, në kuadër të masave kundër COVID 2019, si dhe procesit elektoral të 25 Prilli 2021.

II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushtetë barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar. Arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane. Rritja e aksesit në AP, përfshirja e 100% e fëmijëve 5 vjeçare në klasat përgatitore; Rritja e viteve të shkollimit. Rritja e autonomise së shkollave; Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në AB, Tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në AB. Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve. Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimit të mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB, Shtrirja e shërbimit të punonjesit social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara.

Ndër objektivat dhe produktet/ aktivitetet/ shërbimet që janë financuar me përparësi, në këtë grup shpenzimesh për vitin 2021;

Objekti 1: Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

Ndër objektivat dhe produktet/ aktivitetet/ shërbimet që janë financuar me përparësi, në këtë grup shpenzimesh për vitin 2021;

- **Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor 84%, ndjekja e arsimit bazë (nga 100% e moshës 6-16), si dhe përfshirja me përparësi e grupeve vulnerabël.** Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% ose 350-500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me AK. Reformimi i arsimit parashkollor dhe bazë, përmes miratimit të kornizës së re kurrikulare dhe programeve për çdo grupmoshë për arsimin parashkollor, bazë, trajnimin të përvitshëm të mësuesve/ edukatorëve dhe punonjësve të shërbimit psikosocial (150 psikologë dhe 150 punonjës social) dhe pajisjes me materiale didaktike të kopështeve dhe shkollave.

Objekti 1.1 Kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e kompetencave të të nxënësit gjatë gjithë jetës, plotësimi i paketës kurrikulare të arsimit parashkollor. **Arsimi parashkollor, realizimet:**

- Janë hartuar dhe miratuar programet e reja mësimore bazuar në kompetenca për çdo grup-moshë për sistemin e arsimit parashkollor (për moshën 3-6 vjeç);
- Janë hartuar dhe miratuar Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm të Mësuesit të Arsimit Parashkollor.
- Janë hartuar programet e kualifikimit për mësuesit e arsimit parashkollor.
- Kurrikula e arsimit parashkollor është e përmblusur në paketën e plotë: Kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor; standardet e zhvillimit dhe të nxënësit; programet e moshës 3-4 vjeç, programet kurrikulare 5-6; Kornizën e vlerësimit.
- Gjatë vitit shkollor 2019-2020 zbatohet kurrikula me kompetenca në të gjithë sistemin e arsimit parashkollor nga moshë 3-6 vjeç.

Në vitin shkollor 2017-2018, janë regjistruar dhe ndjekin arsimin parashkollor 81,026 fëmijë ose rreth 80-82% e fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç, nga të cilët 73 884 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç të regjistruar dhe ndjekin arsimin parashkollor në institucione publike.

Në vitin shkollor 2018-2019, aksesit i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor është në masën 82% ku a 78 942 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor nga të cilët 71,563 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor publik.

Në vitin shkollor 2019-2020, aksesit i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor është në masën 82-83% ku 77,858 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor nga të cilët 67,785 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor publik.

Në vitin shkollor 2020-2021, aksesit i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor është në masën 82% ku 71,322 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor nga të cilët 61,953 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor publik.

Shqipëria duhet t'i japë përparësi viteve të hershme, nga parashkollori deri në klasën e tretë, në mënyrë që të sigurojë një bazë të fortë gjuhësore dhe numerike. Duhet të ketë përmirësim të infrastrukturës dhe të bazës materiale për qëllime mësimore. Të organizohet zhvillimi profesional i drejtuesve të rrjeteve profesionale të arsimit parashkollor për dokumentacionin e ri kurrikular.

Nxenes ne Arsimin Parauniversitar 2018-2019				
Nxenes	TOTAL	Publik	Privat	
Gjithsej	501,902	456,409	45,493	
Arsimi Parashkollor	78,942	71,563	7,379	
Arsimi Baze	306,530	282,906	23,624	
Arsimi i Mesem	116,430	101,940	14,490	
Gjimnaz	91,451	78,937	12,514	
Gjimnaz full -time	86,823	74,309	12,514	
Gjimnaz part-time	4,628	4,628	0	
Social-Kulturor	3,908	3,908	0	
Gjimnaze te orientuara (full-time)	3,908	3,908	0	
Profesional	21,071	19,095	1,976	
Profesional (full-time)	20,806	19,095	1,711	
Profesional (part-time)	265		265	
Nxënës në Maturë	36,881	32,462	4,419	

Nxënës në Arsimin Parauniversitar, 2019-2020				
Nxenes	TOTAL	Publik	Privat	
Gjithsej	462,606	415,280	47,326	

Arsimi Parashkollor	77,858	67,785	10,073
Arsimi Baze	294,879	270,113	24,766
Arsimi i Mesem	89,869	77,382	12,487
Gjimnaz	86,850	74,363	12,487
Gjimnaz full -time	81,958	69,471	12,487
Gjimnaz part-time	4,892	4,892	0
Shkolla te mesme te orientuara	3,019	3,019	0
Gjimnaze te orientuara (full-time)	3,019	3,019	0

Nxenes ne Arsimin Parauniversitar 2020-2021				
Nxenes	TOTAL	Publik	Privat	
Gjithsej	446,783	400,581		46,202
Arsimi Parashkollor	71,332	61,953		9,379
Arsimi Bazë	286,486	261,780		24,706
Arsimi i Mesëm i Lartë	88,965	76,848		12,117
Gjimnaz	86,186	74,069		12,117
Gjimnaz full -time	81,198	69,081		12,117
Gjimnaz part-time	4,988	4,988		0
Shkolla te mesme te orientuara	2,779	2,779		0
Gjimnaze te orientuara (full-time)	2,779	2,779		0

Nxenes ne Arsimin Parauniversitar 2021-2022				
Nxenes	TOTAL	Publik	Privat	
Gjithsej	435,710	386,353		49,357
Arsimi Parashkollor	72,384	62,104		10,280
Arsimi Bazë	278,138	251,207		26,931
Arsimi i Mesëm i Lartë	85,188	73,042		12,146
Gjimnaz	82,367	70,221		12,146
Gjimnaz full -time	77,452	65,306		12,146
Gjimnaz part-time	4,915	4,915		0
Shkolla te mesme te orientuara	2,821	2,821		0
Gjimnaze te orientuara (full-time)	2,821	2,821		0
Nxënës në Maturë	27,879	23,859		4,020

- **Financimi i aktiviteteve të parashikuara për arsimin parashkollor**, aktualisht rreth 85% e fëmijëve 3-6 vjec ndjekin arsimin parashkollor. Në 2021 synohet të sigurohet akses i fëmijëve në arsimin parashkollor në nivelin 85-86% per grupmoshën 3-6 vjeç, do të sigurohet në nivelin 95-100% akses i fëmijëve te grupmoshës 5-6 vjeç në arsimin parashkollor ku përfitues janë 72,384 fëmijë nga të cilët **62,104 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor publik**, me një fond prej 32 milion lekë (pa përfshire investimet).

- Burimet njerëzore ku përfshihen rreth 4,400 mësues dhe edukatorë si dhe 3,100 punonjës në shërbimet e arsimit parauniversitar, **si dhe fondet për arsimin parashkollor** si dhe fondet për shërbimet në arsimin parauniversitar në shumën prej 6.2 miliard lekë janë të miratuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore në formë grand, transfertë pakushtëzuar për këtë shërbim janë decentralizuar dhe aktualisht menaxhohen **njësitë e vetëqeverisjes vendore**.
- 3,725 nxënës romë dhe 7,794 nxënës egjiptianë (pa përfshirë nxënësit e shkollave private dhe kopshtet) ndoqën rregullisht mësimet online në mars-maj të këtij viti. Format e ndjekjes së mësimetve prej tyre ishte e ndryshme, sikurse dhe nxënësit e tjerë të klasave 1-12. Një mënyrë ishte ndjekja e mësimetve të dërguara nga mësuesit në grupet e Ëhastapp, telefon, zoom, Google Classroom, viber, facebook, por dhe në Akademia.al, në youtube, në Messenger etj. dhe në TVSh.
- Në sajë të bashkëpunimit mësues-nxënës-prindër dhe pas dhurimit të 5,438 pajisjeve digjitale (telefona dhe tableta për nxënësit në vështirësi ekonomike), u zhvillua mësim në shkollë në datat 31 gusht deri 11 shtator 2020, për plotësimin e mësimetve të muajve mars-maj. Informacioni që disponojmë, është për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar, pa bërë dallimin nëse këta nxënës ishin romë, egjiptianë, me AK etj. Shkollat, ZVA-të, MASR-ja, por dhe OJF e donatorë mbështetën mbi 500 nxënës romë dhe egjiptianë me telefona, tableta e internet për t'u mundësuar atyre ndjekjen e mësimetve online.
- Në fillim të vitit shkollor 2020-2021, nga kompania Vodafon Albania u shpërndanë 4931 copë tableta dhe mjete elektronike (aparaturë celulare) dhe është në proces shpërndarja e 10,000 tabletave për nxënësit që vijnë nga familjet në nevojë, shtëpitë e të cilëve janë të dëmtuara nga tërmeti, dhe për nxënësit që zhvillojnë mësim në klasa kolektive. Nga 4931 nxënës përfitues gjithsej, 448 nxënës i përkasin pakicës romë dhe 708 nxënës pakicës egjiptiane. Pra, deri tani janë 1156 nxënës romë dhe egjiptianë përfitues.
- Mbi klasat përgatitore**, në vitin 2021 synohet të sigurohet që 96-100% e fëmijëve 5-6 vjeçarë të ndjekin klasat ose grupet përgatitore te arsimit parashkollor.

Arsimimi i personave me aftësi të kufizuara; Një nga prioritetet kryesore të reformimit të sistemit arsimor parauniversitar është gjithpërfshirja dhe mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër risi është vendosja e mësuesve ndihmës për të punuar në institucione dhe klasa gjithpërfshirëse me nxënës me aftësi të kufizuara.

Në vitin shkollor 2020-2021 ishin të punësuar në sistemin e arsimit parauniversitar publik dhe privat rreth **1236 mësues ndihmës (1069 në publik)**, kundrejt 1020 mësuesve ndihmës të një viti më parë. Pra, kemi një rritje prej 21% të mësuesve ndihmës krahasuar me një vit më parë. Raporti fëmijë/mësues ndihmës këtë vit është 3.7. Në vitin shkollor 2018-2019 ishin të punësuar në sistemin e arsimit parauniversitar publik dhe privat rreth 1020 mësues ndihmës (944 në publik), **në vitin 2020 ka arritur në 1069 punonjës/ mësues ndihmës, kundrejt 700 mësuesve ndihmës që ishte në vitin 2018.**

Pra, kemi një rritje prej 52% të mësuesve ndihmës krahasuar me vitin 2018. Raporti fëmijë/mësues ndihmës këtë vit është përmirësuar në 2.6, kundrejt 4.9 që ishte një vit më parë. Në vitin shkollor 2019-2020, në sistemin arsimor parauniversitar ndoqën mësimin në institucione arsimore jospesiale publike dhe private duke filluar nga arsimi parashkollor, 4 566 nxënës

(13% më shumë se një vit më parë). Rreth 70% e fëmijëve me AK të regjistruar ndjekin arsimin bazë, 19% arsimin parashkollor dhe pjesa tjetër arsimin e mesëm të lartë.

Raporti i nxënësve me AK që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës ndaj arsimit special është përmirësuar nga 75% që ishte në vitin 2014 në rreth 90% në vitin 2019-2020. Pra, vetëm 10% (ose 527 nxënës) e fëmijëve me AK të regjistruar, ndoqën shkollat speciale apo institutet kombëtare për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë në vitin e kaluar shkollor.

Me rëndësi ishte edhe këtë vit **mbështetja për zhvillimin profesional të mësuesve ndihmës**.

- Janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës dhe është bërë trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Është bërë planifikimi buxhetor për trajnimin e përvitshëm të mësuesve ndihmës me buxhetin e MASR.
- Me rritjen e numrit të mësuesve ndihmës, sidomos dy vitet e fundit, MASR në bashkëpunim me ASCAP filloi punën për **mbështetjen dhe zhvillimin profesional të mësuesve ndihmës**, proces i cili është në vazhdim.
